

UDHËZIM
Nr. 7, datë 12.4.2023

**PËR MIRATIMIN E TREGUESVE DHE KRITEREVE QË DUHET TË ARRIJNË
SUBJEKTET QË OFROJNË SHËRBIME NË SEKTORIN E UJËSJELLËS-
KANALIZIMEVE**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të shkronjës “F”, të pikës 13, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”,

UDHËZOJ:

1. Treguesit dhe kriteret, që duhet të arrijë çdo subjekt që është ofrues i shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, janë sipas shtojcave nr. 1 dhe nr. 2, të këtij udhëzimi.
 2. Treguesit dhe kriteret e parashikuara në këtë udhëzim duhet të jenë të përfshira në kontratën e performancës, që lidhet nëpërmjet palëve.
 3. Indikatorët dhe njësitë matëse, sipas shtojcave nr. 1 dhe nr. 2 të këtij udhëzimi, plotësohen, sipas rastit, për secilën shoqëri të ujësjellës-kanalizimeve.
 4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqëritë ujësjellës-kanalizime.
- Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

Indikatorët e Performancës Viti 2023 " Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime						Sh.a"
Nr	Përshkrimi i Indikatorit	Njësia Matëse	Njësia UK	Njësia UK		Shoqëria Rajonale UK
1	Besueshmëria e të dhënave					
	Tregues Teknikë dhe Tregëtarë					
2	Uji pa të ardhura	%				
3	Shtimi i lidhjeve të reja	nr				
4	Vendosja e matësve të konsumit	nr				
	<i>Lidhje Familjare që aktualisht janë pa matës</i>	nr				
	<i>Lidhje Ente private që aktualisht janë pa matës</i>	nr				
	<i>Lidhje Institucione që aktualisht janë pa matës</i>	nr				
5	Matja e vëllimit të prodhimit	%				
6	Norma mesatare e Faturimit në m ³	m ³				
	" Familjare "	m ³				
	"Ente private"	m ³				
7	Arketimi Faturës Korente	%				
	"Familjare"	%				
	"Ente Private"	%				
	"Institucione"	%				
8	"Arkëtim Total"(Korente +Debi)	%				
9	Likujdimi i faturës Korente të OSHEE	%				
10	Reduktimi i debisë ndaj OSHEE	Akt/Marrëveshje				
11	Efiçenca e stafit të ujësjellësit	Staf/1000 Lidhje				
	Menaxhim					
12	Miratim Plan Biznesi 5 vjeçar.	po/jo				
13	Mbulimi i KDO me arkëtim	%				

[illegible]